VENDIM
Nr. 37, datë 4.11.2013

PËR SHFUQIZIMIN E DY VENDIMEVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR

Në zbatim të nenit 14, germat "i" dhe "j", të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Vendimi i KKRR nr. 7, datë 21.3.2001 për miratimin e rregullores "Mbi rregullat dhe standardet e punës për personat juridikë që kryejnë aktivitetin e grumbullimit e të shpërndarjes së ujit për konsum publik" dhe vendimi i KKRR nr. 38, datë 12.11.2002, për miratimin e "Rregullores mbi rregullat dhe standardet e punës për personat juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në shërbimin e largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura", shfuqizohen.

2. Ngarkohen strukturat e Entit Rregullator të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi